



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Nr. 1317/2017
Datë: 20/10/2017

**Për: Ministrinë e Drejtësisë,
Z.Abelard Tahiri, Ministër**

**Nga: Oda e Avokatëve të Kosovës
Osman Havolli, Kryetar i OAK-së;**

**Lënda: Kërkesë për rishqyrtimin e propozim/listës së anëtarëve të Komisionit për
Provimin e Jurisprudencës!**

I nderuar Ministër,

Po ju shkruaj në emër të Odës së Avokatëve të Kosovës, në lidhjen me propozimet që Ministria e Juaj i ka dhënë për formimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës,

Më tutje, në misionin e saj, OAK ka qëllim kryesor avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë, duke mbështetur procesin e reformave ligjore. Oda e Avokatëve të Kosovës, vazhdimisht është në mision të përmirësimit të drejtësisë dhe këtë kontribut të saj e ka dhënë për vite më radhë edhe në relacion me anëtarët e saj që e kanë përfaqësuar në Komisionin e Provimit të Jurisprudencës.

Provimi i Jurisprudencës është provim profesional i cili jep mundësinë e hyrjes në profesion të gjuetarëve, prokurorëve dhe avokateve, që kujtojmë se të denjë për të qenë në përbërje të komisionit duhet të jenë njerëz që edhe praktikisht ushtrojnë funksionet e tyre në sistemin e drejtësisë.

Me propozimin e fundit nga Ministria e Juaj, në këtë komision nuk është i përfshirë as edhe një avokat i vetëm, ku dihet mirëfilli se ciklin e sistemit të drejtësisë bashkë me gjuetarët e prokurorët e përbën edhe Avokatia si profesion dhe avokatët si profesionist ligjor.

Kështu qe,

Oda e Avokatëve ndihet e anashkaluar dhe e shqetësuar për këtë fakt, pasi që edhe në takimin e fundit që kishim me Juve në Ministrinë e Drejtësisë me datë 19 shtator 2017, u dakordua që të kemi bashkëpunim ndër institucional.

Për më tepër, ka qenë edhe praktikë e më hershme, që çdo herë në këtë komision është përfshirë të paktën një Avokatë, në cilësinë e anëtarit të Komisionit dhe është hera e parë që Ministria e Drejtësisë e përjashton Odën e Avokatëve, duke mos e përfshirë asnjë anëtar të saj.

Meqenëse, jeni në fazën e përzgjedhjes së Komisionit, pas propozimit tuaj,

Në emër të Odës së Avokatëve të Kosovës, ju lutemi që brenda mundësive të bëni rishqyrtimin e propozimit tuaj, dhe në këtë komision të përfshini dhe Odën e Avokatëve të Kosovës, nëpërmjet përfaqësimit nga ndonjë anëtar i saj.

Paraprakisht, ju faleminderit!

Duke shpresuar në arsyeshmërinë e kësaj kërkesë, Ju uroj të gjitha të mirat!

Me respekt,



**Osman HAVOLLI, Kryetar
Oda e Avokatëve të Kosovës**